Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.I
Deçan,dt.29.01.2019

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e I-rë të rregullt të KPF-së , me dt.29.01.2019.
Në mbledhje merrnin pjesë: 7 anëtar të KPF-së , drejtori i Drejtorisë për Administratë, , Zyrtarja për informim.
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Haki Shehaj.
Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi propozimit të Planit të punës së Kuvendit për vitin 2019,
3. Shqyrtimi i propozimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe të KPF-së për vitin 2019,
4. Shqyrtimi i Propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve,
5. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores Komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Deçanit,
6. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për ndarjen e 10,000 € si subvencionim për ndërtimin e shtëpive me donator për aspekt humanitarë,
7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për emërimin e rrugëve
8. Shqyrtimi i propozim listës së vlerave të trashëgimisë natyrore në Komunën e Deçanit,
9. Shqyrtimi i kërkesave,
10. Të ndryshme.

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
Miratohet njëzëri pa vërejtje.
II. Shqyrtimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2019.
Kryesuesi- e prezentoj pikën dhe e hapi debatin rreth saj.
Mon Selmonaj-thot se është i njëjti nga viti i kaluar të cilin nuk e kemi përmbushë dhe propozon që të hiqet muaji i pushimit gushti sepse po parashifet me vendim të orarit të mbledhjeve.
Kryesuesi- thot se janë obligime ligjore të cilat duhet të përmbushen.
Fatmir Kurmehaj-thot se vërejtja kryesore për planin e punës së vitit të kaluar ka qenë mos debatimi i raporteve që kanë qenë të planifikuara (raporti i auditorit të jashtëm, raporti financiar 9 mujor), sa i përket planit jam për ate që me qenë ma koshient dhe mos ti lëmë gjërat të na ikin.
Albana Avdiu –thot se ne bashkarisht do ti përmbushim këto obligime.
Rekomandim:nga antarët e KPF-së u vlerësua si plan i mirë, mirëpo kanë thënë që edhe vitin e kaluar e kemi miratuar planin e punës por i njëjti nuk është përmbushë nga Ekzekutivi, siq është rasti me raportin 9(nëntë) mujor të shpenzimeve dhe raporti i auditorit të jashtëm nuk ka ardhë fare në Kuvend për shqyrtim, në vazhdim ata kanë kërkuar që mbledhjen e radhës të jetë në rend dite raporti i auditorit të jashtëm për vitin 2017, planin si të tillë e dërgojnë në Asamble për shqyrtim dhe miratim.
III.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe të KPF-së për vitin 2019.
Rekomandim: Propozim Vendimi përcillet për shqyrtim dhe miratim ne Kuvend pa ndryshime.

IV.Shqyrtimi i Propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve.
Kryesuesi- e ka prezentu pikën pastaj ka sqaruar se kjo projekt rregullore eshte shqyrtuar sipas procedurave të parapara ligjore, pastaj ka thënë se te neni 5 fjala "vendim " i komisionit vlerësues duhet të zëvendësohet me fjalën "Rekomandim" i komisionit vlerësues dhe poashtu duhet të rishqyrtohet përbërja e komisionit.
Fatmir Kurmehaj- ka kërkuar që bursat e studentëve të hiqen nga rregullorja dhe të planifikohen me buxhet të rregullt vjetorë, kurse për këtë vit të ndahen me rishikim të buxhetit.
Mon Selmonaj- te kriteret për bursa te pika 1.6 e nenit x.të hyn edhe kimia dhe biologjia te nota 8.0.
Fatmir Kurmehaj- thot se këtu duhet të thuhet drejtimet deficitare të gjitha (te nota 8.0)
Rekomandim:KPF gjatë shqyrtimit të këtij propozimi kanë propozuar që bursat e studentëve të ndahen me buxhet vjetor të planifikuar.Te neni 5 fjala "vendim " i komisionit vlerësues duhet të zëvendësohet me fjalën "Rekomandim" i komisionit vlerësues, te neni 5 të rishqyrtohet përbërja e komisionit dhe të harmonizohet me ligjin në fuqi, te neni -X- pika 1.6 duhet të hyjnë te gjitha "drejtimet deficitare", si të tillë i ipet viza për trajtim në Kuvend.
V.Shqyrtimi i Projekt-Rregullores Komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Deçanit.
Mon Selmonaj- kërkon sqarime shtesë në kuvend te neni 14.
Rekomandim:KPF kanë shqyrtuar projekt rregulloren e ofruar dhe kanë kërkuar sqarim te neni 14-Komisioni monitorues, mirëpo meqenëse Drejtori i drejtorisë për MSH dhe SHP si propozues i saj nuk ishte prezent në mbledhje këtë sqarim e kërkojnë në mbledhje të asamblesë. Rregullorja kalon për shyqrtim dhe miratim në Kuvend.
VI.Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për ndarjen e 10,000 € si subvencionim për ndërtimin e shtëpive me donator për aspekt humanitarë.
Rekomandim: me vendim unanim të KPF-së përkrahet dhe përcillet në Kuvend për marrje të vendimit përfundimtarë.
VII.Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për emërimin e rrugëve.
Rekomandim: KPF pas shqyrtimit të kësaj pike, e përkrahin rekomandimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe e përcjellin për Kuvend ku edhe do të merret vendimi.
VIII.Shqyrtimi i propozim listës së vlerave të trashëgimisë natyrore në Komunën e Deçanit.
Mon Selmonaj-i rekonandoj kuvendit që edhe hapsirat publike të fshatit Rastavicë dhe Irzniq të hyjnë në këtë listë.
Rekomnadim:KPF e përkrahin listën e propozuar dhe rekomandojnë që edhe hapsirat publike në fshatin Rastavicë dhe Irzniq të hyjnë në këtë listë.
IX.Shqyrtimi i kërkesave.
Kërkesat financiare nuk shqyrtohen pa u miratu buxheti nga niveli qëndrorë.
X.Të ndryshme.
Mon Selmonaj-ka ngritë si qështje dhe kërkon të njoftohet pse është ndërpre puna e Komisionit për objekte sociale.
Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse
Dyke Llolluni

Verifikon procesverbalin

Kryesuesi i KPF-së
Haki Shehaj

Nga: Komiteti për Politikë dhe Financa
Përmes : Kryesuesit, z.Haki Shehaj
Për: Anëtarët e Asamblesë Komunale
Lënda: Rekomandime të dala nga mbledhja e KPF-së e dt.29.01.2019.
Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.01.2019 ka shqyrtuar pikat e rendit të ditës të cilat janë temë shqyrtimi edhe në mbledhjen e asamblesë të dt.31.01.2019, dhe për të njëjtat bënë rekomandimet si në tekstin në vijim:

1. Shqyrtimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2019.

Rekomandim:nga antarët e KPF-së u vlerësua si plan i mirë, mirëpo kanë thënë që edhe vitin e kaluar e kemi miratuar planin e punës por i njëjti nuk është përmbushë nga Ekzekutivi, siq është rasti me raportin 9(nëntë) mujor të shpenzimeve dhe raporti i auditorit të jashtëm nuk ka ardhë fare në Kuvend për shqyrtim, në vazhdim ata kanë kërkuar që mbledhjen e radhës të jetë në rend dite raporti i auditorit të jashtëm për vitin 2017, planin si të tillë e dërgojnë në Asamble për shqyrtim dhe miratim.

2. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe të KPF-së për vitin 2019.

Rekomandim: Propozim Vendimi përcillet për shqyrtim dhe miratim ne Kuvend pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve.

Rekomandim:KPF gjatë shqyrtimit të këtij propozimi kanë propozuar që bursat e studentëve të ndahen me buxhet vjetor të planifikuar.Te neni 5 fjala "vendim " i komisionit vlerësues duhet të zëvendësohet me fjalën "Rekomandim" i komisionit vlerësues, te neni 5 të rishqyrtohet përbërja e komisionit dhe të harmonizohet me ligjin në fuqi, te neni -X- pika 1.6 duhet të hyjnë te gjitha "drejtimet deficitare", si të tillë i ipet viza për trajtim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores Komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Deçanit.

Rekomandim:KPF kanë shqyrtuar projekt rregulloren e ofruar dhe kanë kërkuar sqarim te neni 14-Komisioni monitorues, mirëpo meqenëse Drejtori i drejtorisë për MSH dhe SHP si propozues i saj nuk ishte prezent në mbledhje këtë sqarim e kërkojnë në mbledhje të asamblesë. Rregullorja kalon për shyqrtim dhe miratim në Kuvend.

1. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për ndarjen e 10,000 € si subvencionim për ndërtimin e shtëpive me donator për aspekt humanitarë.

Rekomandim: me vendim unanim të KPF-së përkrahet dhe përcillet në Kuvend për marrje të vendimit përfundimtarë.

2. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për emërimin e rrugëve.

Rekomandim: KPF pas shqyrtimit të kësaj pike, e përkrahin rekomandimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe e përcjellin për Kuvend ku edhe do të merret vendimi.

3. Shqyrtimi i propozim listës së vlerave të trashëgimisë natyrore në Komunën e Deçanit.

Rekomnadim:KPF e përkrahin listën e propozuar dhe rekomandojnë që edhe hapsirat publike në fshatin Rastavicë dhe Irzniq të hyjnë në këtë listë.

Procesmbajtëse:Dyke Llolluni

Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.II
Deçan,dt.25.02.2019

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e II-të të rregullt të KPF-së , me dt.25.02.2019.
Në mbledhje merrnin pjesë: 7 anëtar të KPF-së , drejtori i Drejtorisë për Administratë, Zyrtarja për informim.
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Haki Shehaj.
Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për MSH dhe SHP për caktimin e lokacionit për Deponi inerte,
3. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për MSH dhe SHP për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kompanisë Komunale të pastrimit "Higjiena",
4. Shqyrtimi i Planit komunal të veprimit për Efiçiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021,
5. Shqyrtimi i Vlerësimit të Rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Deçanit ,
6. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Jashtëm,
7. Shqyrtimi i propozimit për orientimin e të hyrave të bartura të vitit 2018 në vitin 2019,
8. Shqyrtimi i kërkesave,
9. Të ndryshme.

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
Miratohet njëzëri pa vërejtje.

1. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për MSH dhe SHP për caktimin e lokacionit për Deponi inerte.

Kryesuesdi- e ka prezentu piken pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë drejtorit të drejtorisë për MSH dhe SHP.
Drejtori- ka sqaruar se caktimi i këtij lokacioni është shum e nevojshme, mirëpo kjo është kusht edhe për performancë të Komunës, lokacioni caktohet për periudhën e ardhshme dy vjeçare, do të menagjohet mirë nga personi i autorizuar dhe gjendja do të jetë nën kontroll, forma si do të menagjohet do të kalon në procedura tjera , përmes vendimit të Kryetarit.
Mon Selmonaj- fillimisht ka kërkuar nga Kryesuesi i KPF-së që të respektohet rregullorja e punës së Kuvendit dhe mos të marrin fjalën kush don dhe sa her të don për të njëjtën qështje, pastaj e vlerëson si punë të mirë caktimin e lokacionit për hedhje të mbeturinave, sepse tha ai kam pas kërkuar edhe më herët nga Ekzekutivi që të ndërmerr të gjitha masat ligjore me polici dhe gjyqësorë dhe ndotësit e ambientit të ndëshkohen sepse buxheti komunal për çdo vit nuk bën të shpenzohet për heqje të mbeturinave, në vazhdim ka shtruar pyetjen se kush ka të drejtë të hedhë mbeturina aty dhe a ka ndonjë lokacion tjetër më të përshtatshëm.
Drejtori- sqaron se e kemi një rregullore komunale e cila cakton gjobat për ata që bëjnë shkelje në këtë drejtim, në Deçan ka thënë ai nuk kemi pasur mundësi të gjejmë lokacion për afat të gjatë

prandaj propozimi është që lokacioni në fjalë të caktohet për periudhën dy vjeçare, aty vlenë për tërë qytetarët e komunës të cilët do të njoftohen përmes njoftimit publik.
Valdet Nuraj- thot, mendoj se nuk është vend i duhur aty për këtë punë sepse aty është shtrati i lumit Behovc dhe duke qitë mbeturina ai shum shpejt do të mbyllet dhe ai lum kur rritet nga të reshurat ka fuqi të madhe shkatërruese, prandaj propozoj që fillimisht të rregullohet shtrati i lumit e pastaj të hudhen mbeturinat, pastaj shtron pyetjen a mund të hudhin mbeturina kush don dhe a do të bëhet me pagesë, mirëpo nëse nuk menaxhohet mirë dhe nuk shtyhet bërllogu poshtë atëherë do të qitet jashtë lokacionit të caktuar dhe do të del në prona private.
Drejtori- sqaron se do ta funksionalizojmë së pari e pastaj e menaxhojmë mirë dhe nuk do të lejojmë të mbyllet shtrati i lumit.
Fatmir Kurmehaj- vërejtje esenciale dhe kryesore ka të bëj me diçka që shifet qartë sepse aty pamja është e tmerrshme sepse aty kalon rruga kryesore plus janë lokalet hoteliere përballë që lënë shije të keqe për syrin e qytetarit, prandaj ka thënë ai kërkoj që të bëhet analizë e mirë dhe mos të marrim vendime të gabuara, propozoj që ajo hapsirë të rehabilitohet dhe ti ipet mundësia dikuj që të investon në atë pjesë, si dhe nëse ndodhë ndonjë fatkeqësi aty nga mbyllja e shtratit të lumit kush e merr përgjegjësinë për te, prandaj propozoj që të shiqohet mundësia për gjetjen e ndonjë lokacioni tjetër më të pështatshëm, në fund kërkon edhe listën e pronave komunale.
Rekomandim:KPF e shqyrtuan këtë kërkesë dhe vlerësuan se bëhet një punë shum e mirë në këtë drejtim , mirëpo ata kanë kërkuar që lokacioni të caktohet në një vend tjetër nëse ne kemi hapësira për këtë punë, me arsyetimin se lokacioni gjendet afër rrugës kryesore dhe lokaleve ku frekuentohen nga vizitorët dhe pamja e mbeturinave aty ka shije të keqe për sy, u tha se duhet pasur kujdes se është rrezik se do të mbyllet shtrati lumit të Behovcit dhe pastaj bëhet shum i rrezikshëm për hapsirat për rreth, poashtu u kërkua që të menaxhohet mirë.
Pas sqarineve të dhëna nga drejtori i Drejtorisë për MSH dhe SHP, Izet Zenuni, se lokacioni caktohet për periudhën e ardhshme dy vjeçare, se do të menagjohet mirë nga personi i autorizuar dhe gjendja do të jetë nën kontroll, KPF e përcjellin kërkesën për shqyrtim dhe marrje të vendimit në Kuvend, ku do të debatohet prap rreth saj.

2. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për MSH dhe SHP për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kompanisë Komunale të pastrimit "Higjiena".

Kryesuesi-e ka prezentu piken pastaj per sqarime fjalën ia kalon drejtorit të Drejtorisë për MSH dhe SHP, Izet Zenuni, i cili sqaron se është duke u bërë riorganizimi i kompanisë së re, është konstatuar se lokacioni i propozuar te ish stadioni i qytetit i plotëson kushtet.
Fatmir Kurmehaj- thot se ka qenë mirë me na ardhë me shkrim sa lokacion nevoiten sipas projektit per ndërtim te objektit sepse nuk është specifikuar dhe a është sipas planit rregullues, si dhe listën e pronave komunale me na sjellë.
Kushtrim Loshaj- si KPF kërkojmë që në mbledhje të vjen drejtori i Gjeodezisë dhe me na dhënë sqarime për pronat komunale.
Rekomandim: KPF e kanë shqyrtuar kërkesën dhe kanë vlerësuar se është më se e nevojshme ngritja e një objekti të ri për Kompaninë Higjiena , mirëpo kanë kërkuar të ju prezantohet me shkrim nga drejtori i drejtorisë për Gjeodezi, sa është sipërfaqja e lokacionit që duhet të caktohet, të sqarohet se a është në harmoni me Planin rregullues ngritja e objektit si dhe të sjellët lista e pronave komunale.Kërkesa përcillet për shqyrtim, dhënie të sqarimeve të kërkuara dhe marrje të vendimit në Kuvend

3. Shqyrtimi i Planit komunal të veprimit për Efiçiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021.

Drejtori i Drejtorisë për MSH dhe SHP ka sqaruar se ne kemi pasur një plan të miratuar në vitin 2010 mirëpo prej asaj kohe ka ndryshuar gjendja, këtu përfshihet krejt territori i komunës.
Rekomandim: pas sqarimeve të dhëna nga drejtori, Izet Zenuni, KPF e përcjellin në Kuvend për shqyrtim dhe aprovim.

4. Shqyrtimi i Vlerësimit të Rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Deçanit.

Rekomandim: Drejtori i Drejtoris për MSH dhe SHP ka dhënë sqarime, anëtarët e KPF-së e përcjellin në Kuvend , ku do të debatohet prap rreth tij.

5. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Jashtëm.

Rekomandim: KPF kanë debatuar rreth këtij raporti , pastaj e përcjellin për shqyrtim në Kuvend.

6. Shqyrtimi i propozimit për orientimin e të hyrave të bartura të vitit 2018 në vitin 2019.

Rekomandim; KPF e kanë shqyrtuar propozimin e ofruar për orientim të mjeteve dhe pas sqarimeve të dhëna nga drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Agron Demukaj, e përcjellin pa ndryshime për shqyrtim dhe marrje të vendimit në Kuvend.

7. Shqyrtimi i kërkesave.

1.Kërkesa e KF"Deçani", 2.Kërkesa e KF"Besa "Irzniq dhe 3.Kërkesën e KH"Jusuf Gërvalla" Deçan, femrat.

Rekomandim:KPF ka shqyrtuar kërkesat financiare për përkrahje të klubeve sportive:1.Kërkesa e KF"Deçani", 2.Kërkesa e KF"Besa "Irzniq dhe 3.Kërkesën e KH"Jusuf Gërvalla" Deçan, femrat. Anëtarët e KPF-së pas shqyrtimit të këtyre tri kërkesave kanë kërkuar që ti përcjellin për shqyrtim në Kuvend, ku duhet të prezantohet për çdo klub kryesia e Klubit për të dhënë sqarime dhe pastaj Kuvendi sipas mundësive financiare do të vendosë për shumën që do të mund të përkrahen çdo njëri prej tyre.

IX.Të ndryshme.

Mon Selmonaj ka paraqitë kërkesën e 27 qytetarëve të fshatit Rastavic rreth projektit të autostradës e cila kalon nëpër pronat e tyre, ai kërkon që të debatohet rreth shqetësimit të qytetarëve për projektin e autostradës që kalon kah fshati Rastavicë.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse
Dyke Llolluni

Verifikon procesverbalin

Kryesuesi i KPF-së
Haki Shehaj

Nga: Komiteti për Politikë dhe Financa
Përmes : Kryesuesit, z.Haki Shehaj
Për: Anëtarët e Asamblesë Komunale
Lënda: Rekomandime të dala nga mbledhja e KPF-së e dt.25.02.2019.
Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me dt. 25.02.2019 ka shqyrtuar pikat e rendit të ditës të cilat janë temë shqyrtimi edhe në mbledhjen e asamblesë të dt.28.02.2019, dhe për të njëjtat bënë rekomandimet si në tekstin në vijim:

1. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për MSH dhe SHP për caktimin e lokacionit për Deponi inerte.

Rekomandim:KPF e shqyrtuan këtë kërkesë dhe vlerësuan se bëhet një punë shum e mirë në këtë drejtim , mirëpo ata kanë kërkuar që lokacioni të caktohet në një vend tjetër nëse ne kemi hapësira për këtë punë, me arsyetimin se lokacioni gjendet afër rrugës kryesore dhe lokaleve ku frekuentohen nga vizitorët dhe pamja e mbeturinave aty ka shije të keqe për sy, u tha se duhet pasur kujdes se është rrezik se do të mbyllet lumi i Behovcit dhe pastaj bëhet shum i rrezikshëm për hapsirat për rreth, poashtu u kërkua që të menagjohet mirë.
Pas sqarineve të dhëna nga drejtori i Drejtorisë për MSH dhe SHP, Izet Zenuni, se lokacioni caktohet për periudhën e ardhshme dy vjeçare, se do të menagjohet mirë nga personi i autorizuar dhe gjendja do të jetë nën kontroll, KPF e përcjellin kërkesën për shqyrtim dhe marrje të vendimit në Kuvend, ku do të debatohet prap rreth saj.

2. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për MSH dhe SHP për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kompanisë Komunale të pastrimit "Higjiena".

Rekomandim: KPF e kanë shqyrtuar kërkesën dhe kanë vlerësuar se është më se e nevojshme ngritja e një objekti të ri për Kompaninë Higjiena , mirëpo kanë kërkuar të ju prezantohet me shkrim nga drejtori i drejtorisë për Gjeodezi, sa është sipërfaqja e lokacionit që duhet të caktohet, të sqarohet se a është në harmoni me Planin rregullues ngritja e objektit si dhe të sjellët lista e pronave komunale.Kërkesa përcillet për shqyrtim, dhënie të sqarimeve të kërkuara dhe marrje të vendimit në Kuvend

3. Shqyrtimi i Planit komunal të veprimit për Efiçiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021.

Rekomandim: pas sqarimeve të dhëna nga drejtori, Izet Zenuni, KPF e përcjellin në Kuvend për shqyrtim dhe aprovim.

4. Shqyrtimi i Vlerësimit të Rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Deçanit.

Rekomandim: Drejtori i Drejtoris për MSH dhe SHP ka dhënë sqarime, anëtarët e KPF-së e përcjellin në Kuvend , ku do të debatohet prap rreth tij.

5. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Jashtëm.

Rekomandim: KPF kanë debatuar rreth këtij raporti , pastaj e përcjellin për shqyrtim në Kuvend.

6. Shqyrtimi i propozimit për orientimin e të hyrave të bartura të vitit 2018 në vitin 2019.

Rekomandim; KPF e kanë shqyrtuar propozimin e ofruar për orientim të mjeteve dhe pas sqarimeve të dhëna nga drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Agron Demukaj, e përcjellin pa ndryshime për shqyrtim dhe marrje të vendimit në Kuvend.

7. Shqyrtimi i kërkesave.

Rekomandim:KPF ka shqyrtuar kërkesat financiare për përkrahje të klubeve sportive:1.Kërkesa e KF"Deçani", 2.Kërkesa e KF"Besa "Irzniq dhe 3.Kërkesën e KH"Jusuf Gërvalla" Deçan, femrat.
Anëtarët e KPF-së pas shqyrtimit të këtyre tri kërkesave kanë kërkuar që ti përcjellin për shqyrtim në Kuvend, ku duhet të prezantohet për çdo klub kërkesa e Klubit për të dhënë sqarime dhe pastaj Kuvendi sipas mundësive financiare do të vendosë për shumën që do të mund të përkrahen çdo njëri prej tyre.
Procesmbajtëse:Dyke Llolluni

Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.III
Deçan,dt.01.04.2019

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e III-të të rregullt të KPF-së , me dt.01.04.2019.
Në mbledhje merrnin pjesë: 6 anëtar të KPF-së (mungon Valdet Nuraj), Kryetari i Komunës.
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Haki Shehaj.
Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i iniciativës së Kryetarit të Komunës për financimin e projekteve të bashkëpunimit ndërkomunal me Komunat:Pejë, Gjakovë dhe Junik.
3. Shqyrtimi i kërkesave,
4. Të ndryshme.

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
Miratohet njëzëri pa vërejtje.
II. Shqyrtimi dhe miratimi i iniciativës së Kryetarit të Komunës për financimin e projekteve të bashkëpunimit ndërkomunal me Komunat:Pejë, Gjakovë dhe Junik.
Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj per sqarime fjalën ia kalon Kryetarit të Komunës.
Kryetari-ka sqaruar se bëhet fjalë për disa projekte të cilat duhet të financohen nga dy komunat fqinje, ne kete rast kemi te bëjmë me komunën e Pejes, te Gjakoves dhe te Junikut.Projketi me Komunen e Pejes ka te beje me rrugën dhe urën ne fshatin Vranoc, per te cilin do te aplikojme tani, ne vlere prej 259.000 €, ne kete projekt ne jemi lider kurse Peja eshte partner, ndërsa arsyeja e ftesës se mbledhjes ne kohe kaq te shkurtër eshte afati i shkurtër kohor per aplikim ne Ministri, per te cilën jemi dakorduar bashkarisht me ju per te mbajte mbledhje.
Komuna e Pejes e kane mbajte mbledhjen dhe e kane marre vendimin tash pritet edhe vendimi i komunës se Deçanit per te aplikuar per projekt.
Antaret e KPF-se u pajtuan me kërkesën e kryetarit per bashkëfinancim ne projekte meqenëse kjo shkon ne te mire te qytetareve te dy komunave.
Kryesuesi- e qiti ne votim iniciativën e Kryetarit të Komunës për financimin e projekteve të bashkëpunimit ndërkomunal me Komunat:Pejë, Gjakovë dhe Junik.
Antarët e KPF-së e miratuan njëzëri iniciativën dhe si te tillë e përcjellin për Kuvend për marrje të vendimit.
III.Shqyrtimi i kërkesave,
1.Kërkesa e KF"Besa "Irzniq në shumën prej **6,350.00 €**, dhe 2.Kërkesa e KH"Jusuf Gërvalla" Deçan, femrat **në shumën prej 7,375.00 €.**
Anëtarët e KPF-së pas shqyrtimit të këtyre dy kërkesave janë pajtuar që ti përcjellin për shqyrtim në Kuvend, ku duhet të merret vendimi, meqenëse për këto shuma nuk mund të vendosë KPF.
Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse
Dyke Llolluni

Verifikon procesverbalin

Kryesuesi i KPF-së
Haki Shehaj